



AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Përparësi, Objektiva, Tregues
për vitin 2023

Agjencia e Trajtimit të Pronave - Përparësi / Objektiva / Tregues 2023

Deklarata e Përparësive	<p>Përgjatë vitit 2023, Agjencia e Trajtimit të Pronave përparësi kryesore do të ketë ndjekjen deri në miratim të ndryshimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016. Pas miratimeve të ndryshimeve në aktet nënligjore ATP do të vijojë punën për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit si dhe përmbylljen me vendim të dosjeve të patrajuara. ATP do të vijojë të japë mbështetje ligjore dhe do të ndërveprojë me Avokaturën e Shtetit në lidhje me këshillimin ligjor dhe me ekspert teknik gjeodet në proceset gjyqësore. Do të ndjekë me përparësi luftën kundër korrupsionit. Do të ofrojë të gjitha shërbimet për qytetarin online. ATP do të vijojë bashkërendimin e punës me ASHK dhe institucione të treta deri në përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë.</p>
--------------------------------	--

Nr.	Përparësi	Nr.	Objektiva 2023	Nr.	Tregues 2023
1	Ndjekjen deri në miratim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 222/2016	1.1	Ndryshimet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 222/2016 vijnë si reflektim i ndryshimeve ligjore dhe rihapjes së mundësisë së shqyrtimit administrativ nga ATP-ja për dosjet e pa trajtuara me vendim.	1.1.1	Aktualisht ATP është në fazën e konsultimeve me Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me këtë projekt-akt. Afati për ta përmbyllur është data 31.03.2023
2	Ndjekjen deri në miratim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223/2016	2.1	Ndryshimet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 223/2016 vijnë në kuadër të ndryshimeve ligjore, në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimin “Beshiri kundër Shqipërisë dhe 11 kërkesa të tjera”, Vendimit nr. 4 datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vlerësimit të proceseve të brendshme nga ana e ATP-së, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme në lidhje me	2.1.1	Aktualisht ATP është në fazën e konsultimeve me Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me këtë projekt-akt. Afati për ta përmbyllur është data 31.03.2023.

			vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit.		
3	Ekzekutimi i Vendimeve Përfundimtare të Kompensimit	3.1	<p>Ndryshimet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 223/2016 si reflektim i ligjit nr. 77/2023 <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të Pronave.”</i></p> <p>Shpërndarja e Fondit Financiar dhe Fizik për vitin 2023 pas ndryshimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223/2016.</p>	3.1.1	<p>Pranimi i aplikimeve për kompensim nëpërmjet shërbimeve online për qytetarin. Aktualisht janë depozituar 1618 aplikime nga ana e subjekteve të cilat janë në proces trajtimi.</p> <p>Ekzekutimi i të gjitha aplikimeve për vendimet përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit të pronës, të administruara në ATP.</p> <p>Përlllogaritja e vlerës financiare të vendimeve me të drejtë kompensimi, sipas ndryshimeve ligjore ku përcaktohet që vlera e përgjithshme e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, të jetë jo me pak se 10 përqind të vlerës së pronës të llogaritur sipas zërit kadastral aktual <i>(nga një vlerësim paraprak preken rreth 4672 vendime me të drejtë kompensimi)</i>.</p> <p>Afati për përfundimin e procesit të vlerësimit të vendimeve me ndryshim të zërit kadastral është brenda datës 30.03.2023.</p> <p>Identifikimi dhe vlerësimi i vendimeve përfundimtare me të drejtë kompensimi të cilat nuk u vlerësuan nga ATP brenda afatit të përcaktuar në ligj.</p> <p>Afati përgjatë gjithë vitit 2023.</p>

		<p>3.2 Regjistrim, identifikimi, verifikimi dhe pasurimi i fondit të tokës në favor të ATP-së për kompensimin e pronarëve.</p>	<p>3.2.1 Verifikimi i fondit fizik me tokë bujqësore në dispozicion të ATP-së.</p> <p>Me VKM^{në} nr. 770, datë 12.11.2014 ATP-së i janë vendosur në dispozicion 23 400 (<i>njëzet e tre mijë e katëqind</i>) numra pasurie, kanë ngelur të papërcaktuara nëse janë shpërndarë me ligjin 7501/1991 “Për tokën”, nga Njësitë e Qeverisjes Vendore (<i>Bashki dhe Komuna</i>) për 18 929 (<i>tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë</i>) numra pasurie.</p> <p>Afati për realizimin e korrespondencave me institucionet e sipër përmendura është brenda katër-mujorit të parë të vitit 2023.</p> <p>Me VKM^{në} nr. 770, datë 12.11.2014 janë vënë në dispozicion të ATP-së 23 400 (<i>njëzet e tre mijë e katëqind</i>) numra pasurie nga të cilat kanë ngelur të pa përcaktuara për statusin juridik, sipas të dhënave të deri tanishme të marra nga DVASHK-të 5 866 (<i>pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë</i>) numra pasurie.</p> <p>Afati për realizimin e korespondencave me institucionet e sipër përmendura është brenda katër-mujorit të parë të vitit 2023.</p>
--	--	--	--

			<p>3.2.2 Regjistrimi i fondit pyjor pranë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të fondit pyjor i cili është dhënë në administrim ATP-së.</p> <p>Me VKM^{ne} nr. 1077, datë 18.06.2008 ATP^{se} i janë vendosur në dispozicion 6 202 (<i>gjashtë mijë e dyqind e dy</i>) ngastra të cilat janë në formatin e ekonomive pyjore dhe jo në formatin e kërkuar zyrtarisht nga zyrat e kadastrës, me zona kadastrale dhe numra hipotekor.</p> <p>Afati për fillimin dhe kryerjen e procedurave të regjistrimit është përgjatë gjithë vitit kalendarik 2023.</p> <p>3.2.3 Verifikimi fizik i gjendjes faktike të objekteve që i kanë kaluar ATP nëpërmjet VKM^{se} nr. 1696, datë 24.12.2008 si dhe VKM^{se} nr.926, datë 29.12.2014.</p> <p>Aktualisht në dispozicion të ATP^{se} kanë kaluar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, 181 objekte shtetërore të pa privatizuara, gjithashtu në dispozicion të ATP-së kanë kaluar dhe 32 objekte shtetërore të Albminierës dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.</p> <p>Afati i verifikimit të gjendjes fizik është brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2023.</p>
--	--	--	---

4	Shpërndarja e fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga Ndërtimet Informale.	4.1	Këshilli i Ministrave ka miratuar shpërblimin për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga Ndërtimet Informale, nëpërmjet akteve normative, gjithsej ka publikuar 74 VKM.	4.1.1	<p>Administrimi i kërkesave/aplikimeve online nga subjektet përfitues dhe verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjektet si dhe korrespondenca drejtuar ASHK^{-ve} përkatëse.</p> <p>Aktualisht në shqyrtim janë rreth 3060 aplikime, parashikohet të miratohen çdo muaj lista për subjektet përfituese (pas shqyrtimit, administrimit dhe verifikimit të dokumentacionit si dhe korrespondencës me institucionet e treat), mesatarisht 150 kërkesa, në këto kushte për periudhën Janar - Dhjetor 2023, ATP do të ekzekutojë rreth 1800 aplikime.</p>
5	Përmbyllja me vendim e dosjeve të patrajtuara.	5.1	Referuar ligjit nr. 133/2015 ndryshuar me ligjin nr. 77/2022, ATP brenda datës 31.12.2024 do të përmbyll me vendim dosjet e patrajtuara.	5.1.1	<p>Aktualisht për shqyrtim në ATP janë rreth 6500 dosje pa vendim.</p> <p>Përgjatë vitit 2023 do të përmbyllen me vendim rreth 3250 dosje.</p>
		5.2	Ligji nr. 133/2015 i jep mundësinë subjekteve të cilët i janë drejtuar gjykatës të heqin dorë nga procesi gjyqësor dhe ta risjellin dosjen në ATP.	5.2.1	Aktualisht janë tërhequr nga ATP rreth 3084 dosje pa vendim, nga të cilat pritshmëria për kthim për shqyrtim administrative pranë ATP ^{-së} është e lartë.
6	Përfaqësimi Ligjor	6.1	Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë ku Agjencia e Trajtimit të Pronave është palë ndërgjyqëse, në cilësinë e paditesit, të paditur apo personit të tretë.	6.1.1	Mbrotjtja e interesave të ligjshme të ATP-së në rreth 2050 procese gjyqësore, aktualisht në ndjekje dhe ende të pa mbyllura me vendim përfundimtar.

Shtojca II – Plani i Treguesve

Target progresiv 2023

Nr.	Treguesit	Përshkrimi i treguesit	Produkt	12M	Përshkrim i Realizimit	Frekuenca e matjes	Përgjegjës për matjen
1.1.1	<p>Ekzekutimi i Vendimeve për Kompensim me Kërkesë të Veçantë.</p> <p>Ekzekutimi i Vendimeve me Kompensim Financiar dhe Fizik.</p>	<p>Administrimi dhe verifikimi i dokumentacionit në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM 223/2016, i ndryshuar,</p>	<p>Ekzekutimi i 100 vendimeve me Kërkesë të Veçantë.</p> <p>Ekzekutimi i 200 vendimeve me Kompensim Financiar dhe Fizik.</p>	12 M	<p>Ekzekutimi i vendimeve do të jetë në varësi të numrit të aplikimeve nga subjektet si dhe në varësi të Fondit Financiar Buxhetor të vënë në dispozicion nga Ministria e Financës.</p>	6 mujor	Drejtoria e Kompensimit
1.2.2	<p>Regjistrimi i fondit pyjor pranë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të fondit pyjor i cili është dhënë në administrim ATP-së.</p>	<p>ATP në mbështetje të VKM nr.1077, datë 18.6.2008 “Për Krijimin e Fondit Të Kompensimit Fizik Nga Fondi Pyjor dhe Kullosor” të vijoje për bllokimin e tokes pyjore dhe ndryshimeve ligjore ne ligjin 133/2015.</p>	<p>Blokimi i fondit në favor të ATP.</p>	12 M		6- mujore	Drejtoria e Kompensimit

2.1.1	Shpërndarja e fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga Ndërtimet Informale.	Administrimi, shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit. Korrespondenca me institucionet e treta.	Trajtimi i 1800 aplikimeve.	12 M	Në varësi të fondit të alokuar nga ASHK.	3- mujore	Drejtoria e Kompensimit
3.1.1	Përmbyllja me vendim e dosjeve të patrajtuara.	Kryerja e njoftimeve për plotësim dokumentacioni të dosjeve/kërkesave të cilat kanë mangësi në dokumentacion.	Trajtimi me vendim i 3250 dosjeve të patrajtuara.	12 M	Numri i njoftimeve është në varësi të dosjeve/kërkesave të cilat kanë nevojë për plotësim dokumentacioni.	6- mujore	Drejtoria e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie
4.1.1	Ndjekja e procesve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, në juridiksionin civil, administrativ dhe atë penal, për mbi 2000 procese gjyqësore aktualisht aktive, prej nga të cilat 580 pranë rrethit gjyqësor Tirane.	Drejtoria përkatëse merr masa për ndjekjen e proceseve si dhe dërgimin e dosjeve përkatëse një kopje për gjykatën dhe një kopje për palën paditëse.			Në veprimtarinë e përfaqesimit ligjor, ATP-ja bashkërendon punën e saj me Avokaturën e Shtetit si dhe jep asistencën e nevojshme teknike për procese të rëndësishme të veçantë dhe kryesisht aty ku ka kërkesë për investime strategjike.	6- mujore	Drejtoria Juridike

4.2.1	Zbatimi i ligjit në procedurat e vënies ne ekzekutim të titujve ekzekutiv.	Drejtoria përkatëse dërgon njoftim subjekteve për plotësimin e dokumentacineve me qëllim ekzekutimin e tyre aty ku nuk është dërguar shkresë më parë.	Ekzekutimi i dosjeve.	Ekzekutimi i vendimeve do të jetë në varësi bazueshmërisë së kërkesës në ligjin e posaçëm 133/2015, të plotësimit të dokumentacionit nga ana e subjekteve si dhe kërkesës së tyre pranë Drejtorisë së Kompensimit për të ekzekutuar vendimin konform ligjit 133/2015 dhe akteve nënligjore, si dhe në varësi të fondit buxhetor të akorduar.	6- mujore	Drejtoria Juridike
-------	--	---	-----------------------	--	-----------	--------------------